



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 720/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtare, duke vendosur lidhur me apelin e Rrahman Jakupit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 28.10.2021, me objekt të çështjes bartje e votave nga kandidati për Kryetar i një subjekti tek kandidati i subjektit tjetër politik, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet i pabazuar** apeli Anr.720/2021 i datës 28.10.2021, i paraqitur nga Rrahman Jakupi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Shtime, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 28.10.2021, me të cilën ka kërkuar korrigjimin e formularëve për kutin e votimit CB122/002 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021.

#### A r s y e t i m

Me datë 28.10.2021, PZAP ka pranuar apelin Anr.720/2021, nga Rrahman Jakupi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Shtime, me të cilin pretendon se duke u bazuar në rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja për kryetar të Komunës së Shtimes, ku në qendrën e numërimit të rezultateve (QNR), janë bartur votat e personave me nevoja të veçanta të proceduara përmes epikës mobile të kandidatit të PDK-së për Kryetar Komune në Shtime Naim Ismajli, tek kandidati i LDK-së, Bedri Zeqiri, gjë që rrjedhimisht i bie se kandidatit për Kryetar Komune në Shtime nga subjekti politik PDK është dëmtuar me vota të përgjithshme. Parashtruesi i ankesës thekson se duke i krahasuar të dhënat për subjektet i bie se PDK-ja, për Kuvend ka afër 43 vota, ndërsa LDK, si subjekt ka vetëm 1 votë. Andaj i njëjti kërkon nga PZAP-i që të korrigjohet gabimi dhe të vendoset drejt.

Përgjigje në apel ka paraqitur KQZ, me të cilën thekson se në formularin e vjetër bartja e votave për Kryetar është bërë gabim. Votat e subjektit të PDK-së, i janë bartur subjektit të LDK-së dhe ato të LDK-së, i janë bartur subjektit të PDK-së. Si dëshmi ka bashkangjitur të dy format e formularëve, (Formularët e Rezultatit të Dengut – FRD CB 122/002) të vjetrën dhe të rejtën, që e kanë evidentuar dhe përmisuar gabimin.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Me datën 28.10.2021 PZAP-i, ka pranuar apelin Anr.720/2021, nga Rrahman Jakupi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilin pretendon se duke u bazuar në rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ-së, për kryetar të Komunës së Shtimes, ku thekson se në qendrën e numërimit të rezultateve (QNR), janë bartur votat e personave me nevoja të veçanta, te proceduara përmes epikës mobile, të kandidatit për Kryetar Komune në Shtime Naim Ismajli, tek kandidati i LDK-së, Bedri Zeqiri

PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ palët e interesuar mund të parashtrorjnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ-ja me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP thekson se në formularin e vjetër bartja e votave për Kryetar është bërë gabim, ku votat e subjektit të PDK-së, i janë bartur subjektit të LDK-së dhe ato të LDK-së, i janë bartur subjektit të PDK-së. Si dëshmi kanë bashkangjitur të dy format e formularëve, (Formularët e Rezultatit të Dengut – FRD CB 122/002) të vjetrën dhe të rejen, që e kanë evidentuar dhe përmirësuar gabimin.

PZAP duke vlerësuar apelin e parashtruar vlerëson se në rastin konkret apeli është i pabazuar për faktin se nga dëshmitë e bashkangjitura të KQZ-se si dhe nga publikimi i rezultateve në web faqen e KQZ-së për Komunën e Shtimes gjegjësisht për kandidatin e PDK-së Naim Ismajli shihet se gabimet në vota janë korigjuar dhe përmisuar dhe të njëjtat janë publikuar në web faqen e KQZ-së të cilat janë inkorporuar ne rezultatin përfundimtar. Andaj PZAP-i, konstaton se apeli i parashtruar është i pabazuar pasi që evidentimi i votave për kandidatin e PDK-së është përmirësuar.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 720/2021 më datën 31.10.2021



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.